



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
SENATI AKADEMIK

Nr. 1283 prot

Shkodër, më 27.03.2025

VENDIM

Nr. 109 datë 27.03.2025

"PËR DISA SHTESA NË RREGULLOREN E STUDIMEVE NË UNIVERSITETIN E SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 1, gërma d); Statutin e Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", neni 17, pika 6, gërma r); nenit 42, pika 2. të Rregullores së Studimeve në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi", (e ndryshuar), Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 27. 03. 2025,

VENDOSI:

1. Në nenin 14, të rregullores, pas pikës 5, të shtohet pika 6, si vijon:

"6. Përjashtohen nga rregullat detyruese të përcaktuara nga pikat 1 deri në pikën 5 të këtij neni, studentët e rregullt që ndjekin studimet semestrale Erasmus +; CEEPUS dhe programe të tjera të ngjashme, bazuar në marrëveshjet institucionale ku USH është palë (Learning Agreement).

2. Në nenin 31, të rregullores, pas pikës 4, të shtohet pika 5, si vijon:

"5. Studentët e rregullt që ndjekin studimet semestrale Erasmus +; CEEPUS dhe programe të tjera të ngjashme, bazuar në marrëveshjet institucionale ku USH është palë (Learning Agreement), hyjnë në riprovimet e të njëjtit vit me 100 pikë."

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

